



ECIM DREJT SUKSESIT



TË VEPROJMË PËR NJË TË ARDHME TË MIRË

JETMIR (12), GERT (11), JON (12), RINA (12), MJELMA (13), VLERA (12), KANINA (12), GENT (13)



Sa shumë kemi dëgjuar për fjalën demokraci. Por, sot patëm mundësinë që të diskutojmë më shumë dhe të shprehim mendimet tona rreth saj

A meriton një popull të jetë i lirë? A meritojnë njerëzit të jetojnë pa frikë edhe të sigurt? Grupi ynë mendon se po. Ne dhe të gjithë të tjerët e meritojmë lirinë. Jetojmë në një vend ku pikërisht liria është një ndër elementet më të rëndësishme. Pra, jetojmë në një vend demokratik siç është Kosova. Me fjalën demokraci, e cila rrjedh nga gjuha greke, kuptojmë udhëheqjen e popullit. Domethënë në shtetet demokratike, të gjithë qytetarët e kanë të drejtën e vendimmarrjes. Demokracia për herë të parë është paraqitur në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Demokracia atëherë dallon nga koha e sotme, sepse në vitin 507 para erës sonë të drejtën për vendimmarrje e kishin vetëm burrat e pasur. Siq e dijmë, sot të gjithë e kanë të drejtën e votës pa dallim gjinie, moshe, race, etj. Tani, do të tregojmë një shembull ku zbatohet demokracia: „Ishin dy shoqë të cilët dëshironin të shkonin në një udhëtim. Gjatë udhëtimit u doli një problem. Makina e tyre u prish gjatë vozitjes. Një kalimtar i rastit u tregua shumë bujar dhe i ndihmoi ata. Nëse ky kalimtar nuk do t’iu ndihmonte, atëherë udhëtimi i tyre do të merrte fund. Në këtë rast mund të kuptojmë se nëse ne i ndihmojmë njëri-tjetrit, kemi mirëkuptim dhe jemi solidarë, të cilat janë edhe elemente të demokracisë, do të kemi një jetë të lumtur dhe paqësore.



Të drejtat tona në demokraci i kemi të garantuara me ligj. Çdo qytetar duhet të tregohet i përgjegjshëm duke respektuar të tjerët, duke punuar dhe duke vepruar në të mirën e vendit ku jetojnë



Ne jemi grupi „Demokratët e vegjël“. Duke bashkëpunuar dhe duke qenë të përkushtuar e kemi shkruar këtë artikull



E drejta e strehimit për të gjithë qytetarët demokratik



Të bashkuar shkojmë drejt së ardhmes



Mbi moshën 18 vjeçare e kemi të drejtën e punës



Shkolla është vendi ku ne marrim dije




Ejani të jetojmë një jetë paqësore



Ta mbajmë ambientin ku jetojmë sa më pastër



Ne duhet ta pranojmë njëri-tjetrin pa dallime



Kujdesi shëndetësor, e drejta jonë e garantuar me ligj

KUVENDI ËSHTË MIRËQENIA JONË

LUM (13), ALTINA (13), EMA (12), RINESA (13), ERLAND (13), RODON (13), BLIN (13), EDEN (11)



Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues dhe funksioni kontrollues.



Me anë të këtyre vizatimeve dëshirojmë të tregojmë sesi qytetarët nganjëherë tregohen të papërgjegjshëm ndaj ambientit ku ata jetojnë. Për ne është shumë e rëndësishme respektimi i ligjeve.



Unë Blini dhe anëtarët e grupit tim, me shumë dashuri do t'iu informojmë për punën e Kuvendit dhe rolin e tij në jetën tonë

Rinesa dhe Rodoni janë shokë shumë të mirë. Ata gjatë pushimit dimëror kanë kaluar kohë shumë të mirë në rrethin e tyre familjar. Gjatë asaj kohe, që të dy përveç që kanë pushuar, po ashtu, e kanë shfrytëzuar këtë periudhë për të lexuar. Është e drejtë e tyre, të cilët si qytetarë të përgjegjshëm, të dy i gëzojnë. Këto të drejta janë të mbrojtura me ligj, sepse besojmë që ju e dini se të gjithë e gëzojnë të drejtën e familjes, të arsimit, etj.

Është Kuvendi ai institucion i cili bën miratimin e këtyre ligjeve, rëndësia e të cilave është shumë e madhe. Po të mos ekzistonte ligji për arsim apo edukim, ne të gjithë do të kishim shumë mangësi. Mangësi sa i përket anës profesionale. Falë këtyre ligjeve, ne gëzojmë liri e shumë gjëra të tjera. Ligjet që i përmendem dhe shumë e shumë të tjera që nuk i kemi përmendur, miratohen me pëlqimin e deputetëve. Ka ligje të cilat miratohen me 61 vota, nga gjithsej sa janë 120 deputetë. Megjithatë, ka edhe ligje që kërkojnë numër më të madh të votave, varësisht nga rëndësia e ligjit.

Ne nuk po themi që ka ligje të pa rëndësishme, por disa nga ta me të vërtetë kanë rol shumë të madh. Dikush mund të pyet se pse deputetët miratojnë ligje e jo ne si qytetarë? Kjo sepse vendi ynë ka demokraci parlamentare dhe vendimet për popullin i merr Kuvendi.

ndi. Janë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare ata të cilët me votë të lirë iu japin të drejtë deputetëve të marrin vendime për ta.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare, babai dhe nëna ime kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor. Ata kur erdhën në shtëpi na treguan se kësaj radhe kanë votuar për dikënd tjetër. Jo personin që e kishin votuar para 4 vjetëve. Ata më treguan se personin që e kanë votuar atë kohë nuk i ka përmbushur premtimet që i kishte dhënë. Për këtë arsye me thanë prindërit se ai person të cilin e kanë votuar, nuk e meriton votën e tyre. Pra, deputetët e marrin pushtetin prej qytetarëve. Prandaj, duhet të miratojnë vetëm ligje që janë në të mirën e tyre. Ne si qytetarë jemi shumë të rëndësishëm kur është fjala në demokraci. Andaj, të votojmë me kujdes.



Ardhmëria e vendit

TË BËHEMI AKTIV

EGION (12), JON U. (13), DENIS (12), OLTU (12), REA (12), ANJEZA (13), JONA (12), AGULLINA (12)



Sot kuptuam se të jesh aktiv në vendin tënd do të thotë të mendosh edhe për të tjerët

Qyteti ynë Gjakova është shumë i bukur. Ne e duam shumë këtë qytet dhe jemi krenar për të. Megjithatë, nuk mohohet fakti se ka plot mënyra se si ne mund ta bëjmë Gjakovën edhe më të bukur.



Parku i qytetit është shumë i dashur për ne. Shumë shpesh pas mësimit kalojmë kohën atje. Mirëpo, jo vetëm ne. Ai park vizitohet shpesh edhe nga të moshuari. Sidomos, në stinën e pranverës dhe verës. Sado që kemi dëshirë ta kalojmë kohën aty dhe të shijojmë atë ambient, ne nuk mund të qëndrojmë aty kur dielli perëndon dhe errësohet. Kjo për shkak se ndriçimi mungon në park. Kjo është shqetësuese për neve si qytetarë dhe nxënës. Prandaj, kemi menduar dy opsione për zgjidhjen e këtij problemi. Opsioni i

parë është që të bëjmë një kërkesë në komunën e qytetit. Ndërkaq, nëse kërkesa jonë merr kohë derisa të realizohet, atëherë ne do të provojmë që vet të sjellim ndryshim në park. Kjo iniciativë e jona ndryshe mund të quhet edhe punë vullnetare. Puna vullnetare na bën aktiv në vendin tonë.

Aktiv mund të jemi edhe duke marrë pjesë në zgjedhje dhe tubime. Mund të jemi edhe duke marrë pjesë në shoqata apo organizata të ndryshme që kanë për qëllim të mbrojnë të drejtat e njeriut apo fëmijëve, etj. Ju lexues të nderuar, mos harroni se gjithçka që bëni në të mirë të vendit tonë ju bën aktiv dhe ndihmon në rritjen e demokracisë. Andaj, të jemi të gjithë aktiv. Vetëm kështu mund të arrijmë sukses. Bëhuni edhe ju si ne: punëtorë dhe shumë aktiv. Ju mund të rregulloni gjithçka që nuk iu pëlqen. Duhet vetëm vullnet.



Ne sot në rolin e gazetarit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë